Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

TRENDET ZGJEDHORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2009 – 2019

PRISHTINË, 2021

Botues: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Për më shumë informacion kontaktoni Sekretariatin e KQZ-së:

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni: +381 (0) 38 211 034

E-mail: infokqz@kqz-ks.org

Uebfaqe: www.kqz-ks.org

© Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Versioni elektronik i këtij publikimi është në dispozicion për kopjim, redistribuim, remiksim dhe përshtatje në çfarëdo mediumi ose formati, por me kusht që qëllimi i përdorimit të jetë jo-komercial. Nëse materialet remiksohen, transformohen ose përpunohen, produkti i zhvilluar duhet të shpërndahet në kushte të njejta licence, pra si origjinali. (Sipas kushteve të Licences: Creative Commons Attribute-NonCommercial-ShareAlike 3.0)

Ky dokument u hartua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve falënderon Fondacionin Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) në Kosovë për përkrahjen teknike gjatë hartimit të këtij raporti.

Të dhënat e përfshira në analizë të trendeve iu referohen të gjithë votuesve që kanë votuar në shtatë palë zgjedhje, edhe nëse vendvotimet e disa prej këtyre votuesve janë përjashtuar nga rezultatet përfundimtare me vendim të KQZ-së, për arsye të ndryshme. Për këtë arsye, të dhënat e prezantuara në këtë analizë përfshijnë më shumë votues se sa rezultatet të publikuara për secilat nga këto zgjedhje.

PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT 3

LISTA E TABELAVE 5

LISTA E GRAFIKONAVE DHE FIGURAVE TJERA 6

HYRJE 7

SHKURTESAT 8

PËRKUFIZIMET 8

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 9

METODOLOGJIA 10

PJESA E PARË 12

1. TRENDET E PËRGJITHSHME ZGJEDHORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, 2009 – 2019 12

1.1. Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës: 2010; 2014; 2017 dhe 2019 13

1.2. Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet Lokale: 2009; 2013 dhe 2017 14

1.3. Përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje në Republikën e Kosovës, 2009 – 2019 15

1.4. Trendet e pjesëmarrjes në Zgjedhje për Kuvend të Kosovës sipas komunave 16

1.4.1. Pesë komunat me pjesëmarrjen më të lartë dhe më të ulët në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 17

1.5. Trendet e pjesëmarrjes në Zgjedhje Lokale sipas komunave 18

1.5.1. Pesë komunat me pjesëmarrjen më të lartë dhe më të ulët në Zgjedhjet Lokale 19

PJESA E DYTË 21

2. PJESËMARRJA NË ZGJEDHJE SIPAS GJINISË: KUSH VOTON MË SHUMË? 21

2.1. Pjesëmrrja sipas gjinisë në Zgjedhje për Kuvend në të gjitha komunat e Kosovës 23

2.1.1. Të gjeturat për pjesëmarrjen në Zgjedhje për Kuvend sipas gjinisë dhe komunave të Kosovës 25

2.2. Pjesëmarrja sipas gjinisë në Zgjedhjet Lokale në të gjitha komunat e Kosovës 26

2.2.1. Të gjeturat për pjesëmarrjen në Zgjedhje Lokale sipas gjinisë dhe komunave të Kosovës 28

PJESA E TRETË 30

3. PJESËMARRJA NË ZGJEDHJE SIPAS GRUPMPOSHAVE: 30

3.1. Pjesëmarrja e meshkujve dhe femrave në Zgjedhje për Kuvend dhe Zgjedhje Lokale sipas grupmoshave 31

3.2. Pjesëmarrja në Zgjedhje për Kuvend sipas gjinisë dhe grupmoshave (krahasime) 33

3.3. Pjesëmarrja në Zgjedhje Lokale sipas gjinisë dhe grupmoshave (krahasime) 35

3.4. Trendet e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhje për Kuvend dhe Zgjedhje Lokale, sipas grupmoshave, gjinisë dhe komunave 37

3.4.1. Grupmoshat: 18 – 21 vjeç 37

3.4.2. Grupmoshat: 22 – 25 vjeç 39

3.4.3. Grupmoshat: 26 – 40 vjeç 41

3.4.4. Grupmoshat: 41 – 64 vjeç 43

3.4.5. Grupmoshat: 65 – 99 vjeç 45

3.4.6. Grupmosha mbi 100 vjeç 47

PJESA E KATËRT 50

4. TRENDET ZGJEDHORE NË ZONA URBANE DHE ZONA RURALE 50

4.1. Votuesit e zonave urbane dhe rurale 50

4.2. Pjesëmarrja në votime në zonat urbane dhe rurale në 7 komunat (Gjakova, Gjilani, Mitrovica e Jugut, Peja, Prishtina, Prizreni dhe Ferizaj) në Zgjedhje për Kuvend dhe Zgjedhje Lokale 51

4.3. Pjesëmarrja në votime sipas gjinisë në zonat urbane dhe rurale në shtatë komunat (Gjakova, Gjilani, Mitrovica e Jugut, Peja, Prishtina, Prizreni dhe Ferizaj) në Zgjedhje për Kuvend dhe Zgjedhje Lokale 52

4.3.1. Pjesëmarrja në votime në Zgjedhjet për Kuvend sipas gjinisë në zonat urbane dhe rurale të shtatë komunave (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj) 53

4.3.2. Pjesëmarrja në votime në Zgjedhjet Lokale sipas gjinisë në zonat urbane dhe rurale të shtatë komunave (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj) 55

4.3.3. Pjesëmarrja në votime në Zgjedhjet për Kuvend sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale të shtatë komunave (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj) 56

4.3.4. Pjesëmarrja në votime në Zgjedhjet Lokale sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale të shtatë komunave (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj) 58

PJESA E PESTË 60

5. TRENDET ZGJEDHORE TË: VOTIMIT ME POSTË; VOTIMIT ME KUSHT DHE VOTIMIT TË PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA (VPNV) 60

5.1. Votimi me postë 60

5.2. Votimi me kusht në Zgjedhjet për Kuvend dhe Zgjedhjet Lokale 61

5.3. Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta (VPNV) në Zgjedhje për Kuvend dhe Zgjedhje Lokale 64

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Trendet e përgjithshme të votuesve të regjistruar dhe votuesve që kanë votuar në ditën e zgjedhjeve..... 12

Tabela 2: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010. 13

Tabela 3: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2014. 13

Tabela 4: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017. 13

Tabela 5: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019. 13

Tabela 6: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet Lokale 2009. 14

Tabela 7: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet Lokale 2013. 14

Tabela 8: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet Lokale 2017. 14

Tabela 9: Pesë komunat me pjesëmarrjen më të lartë në votime në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. 17

Tabela 10: Pesë komunat me pjesëmarrjen më të ulët në votime në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. 17

Tabela 11: Pesë komunat me pjesëmarrjen më të lartë në votime në Zgjedhjet Lokale. 19

Tabela 12: Pesë komunat me pjesëmarrjen më të ulët në votime në Zgjedhjet Lokale..... 19

Tabela 13: Numri i votuesve të regjistruar dhe atyre që votuan të ndarë sipas gjinisë..... 21

Tabela 14: Komunat me ndryshimet më të mëdha te votuesit meshkuj në Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës. 25

Tabela 15: Komunat me ndryshimet më të mëdha te votuesit femra në Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës. 25

Tabela 16: Komunat me ndryshimet më të mëdha te votuesit në Zgjedhje Lokale. 28

Tabela 17: Komunat me ndryshimet më të mëdha te votuese në Zgjedhje Lokale. 28

Tabela 18: Numri i votuesve sipas grupmoshave që kanë marrë pjesë në votime. 30

Tabela 19: Numri i votuesve të regjistruar sipas grupmoshave dhe sipas gjinisë që kanë marrë pjesë në votime. 31

Tabela 20: Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet për Kuvend të grupmoshave 18 – 21 vjeç..... 37

Tabela 21: Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet Lokale të grupmoshave 18 – 21 vjeç..... 38

Tabela 22: Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet për Kuvend të grupmoshave 22 – 25 vjeç..... 39

Tabela 23: Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet Lokale të grupmoshave 22 – 25 vjeç..... 40

Tabela 24: % e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet për Kuvend të grupmoshave 26 – 40 vjeç 41

Tabela 25: % e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet Lokale të grupmoshave 26 – 40 vjeç 42

Tabela 26: % e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet për Kuvend të grupmoshave 41 – 64 vjeç 43

Tabela 27: % e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet Lokale të grupmoshave 41 – 64 vjeç 44

Tabela 28: % e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet për Kuvend të grupmoshave 65 – 99 vjeç 45

Tabela 29: % e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet Lokale të grupmoshave 65 – 99 vjeç 46

Tabela 30: % e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet për Kuvend të grupmoshës mbi 100 vjeç 47

Tabela 31: % e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë në Zgjedhjet Lokale të grupmoshës mbi 100 vjeç 48

Tabela 32: Numri i votuesve të regjistruar dhe votuesve që kanë votuar në zona urbane dhe zona rurale. 50

Tabela 33: Numri i votuesve meshkuj të regjistruar dhe që kanë votuar në zona urbane dhe rurale. 52

Tabela 34: Numri i votuesve femra të regjistruar dhe që kanë votuar në zona urbane dhe rurale..... 52

Tabela 35: Numri i votuesve të regjistruar dhe atyre që kanë pjesë në zgjedhje përmes postës. 60

Tabela 36: Numri i votave me kusht nga vendvotimet e dyfishta dhe votave të personave me nevoja të veçanta..... 61

Tabela 37: Numri i votave me kusht të konfirmuara dhe të refuzuara..... 62

Tabela 38: Numri i votave me kusht të konfirmuara dhe të ndara sipas gjinisë. 62

Tabela 39: Numri i aplikimeve për regjistrim sipas kategorive VPNV, për të votuar përmes ekipeve mobile. 64

Tabela 40: Numri i aplikimeve për t'u regjistruar për votim përmes ekipeve mobile dhe % e pjesëmarrjes së tyre në votim. 64

LISTA E GRAFIKONAVE DHE FIGURAVE TJERA

Trendet e përgjithshme të pjesëmarrjes në votime 12
Përqindja e pjesëmarrjes në votime 2009 – 2019 15
Pjesëmarrja (%) në Zgjedhje për Kuvend të Kosovës sipas komunave 16
Pjesëmarrja (%) në Zgjedhje Lokale sipas komunave 18
Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas gjinisë (krahasime të përgjithshme) 21
Pjesëmarrja (%) në Zgjedhje për Kuvend të Kosovës sipas gjinisë 22
Pjesëmarrja (%) në Zgjedhje Lokale sipas gjinisë 22
Pjesëmarrja (%) e meshkujve në Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 23
Pjesëmarrja (%) e femrave në Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 24
Pjesëmarrja (%) e meshkujve në Zgjedhjet Lokale sipas komunave 26
Pjesëmarrja (%) e femrave në Zgjedhjet Lokale sipas komunave 27
Pjesëmarrja (%) në votime sipas grupmoshave 30
Pjesëmarrja (%) në votime e meshkujve sipas grupmoshave 32
Pjesëmarrja (%) në votime e femrave sipas grupmoshave 32
Përqindja e pjesëmarrjes në Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2010 sipas gjinisë dhe grupmoshave 33
Përqindja e pjesëmarrjes në Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2014 sipas gjinisë dhe grupmoshave 33
Përqindja e pjesëmarrjes në Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2017 sipas gjinisë dhe grupmoshave 34
Përqindja e pjesëmarrjes në Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2019 sipas gjinisë dhe grupmoshave 34
Përqindja e pjesëmarrjes në Zgjedhjet Lokale 2009 sipas gjinisë dhe grupmoshave 35
Përqindja e pjesëmarrjes në Zgjedhjet Lokale 2013 sipas gjinisë dhe grupmoshave 35
Përqindja e pjesëmarrjes në Zgjedhjet Lokale 2017 sipas gjinisë dhe grupmoshave 36
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në zona urbane dhe rurale 50
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në komunën e Gjakovës sipas zonave urbane dhe rurale 51
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në komunën e Gjilanit sipas zonave urbane dhe rurale 51
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në komunën e Mitrovicës së Jugut sipas zonave urbane dhe rurale 51
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në komunën e Pejës sipas zonave urbane dhe rurale 51
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në komunën e Prishtinës sipas zonave urbane dhe rurale 51
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në komunën e Prizrenit sipas zonave urbane dhe rurale 51
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në komunën e Ferizajt sipas zonave urbane dhe rurale 51
Përiqndja e pjesëmarrjes në votime të meshkujve dhe femrave në zona urbane dhe rurale 52
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet për Kuvend 2010 sipas gjinisë dhe zonave në shtatë komuna 53
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet për Kuvend 2014 sipas gjinisë dhe zonave në shtatë komuna 53
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet për Kuvend 2017 sipas gjinisë dhe zonave në shtatë komuna 54
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet për Kuvend 2019 sipas gjinisë dhe zonave në shtatë komuna 54
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet Lokale 2009 sipas gjinisë dhe zonave në shtatë komuna 55
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet Lokale 2013 sipas gjinisë dhe zonave në shtatë komuna 55
Përqindja e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet Lokale 2017 sipas gjinisë dhe zonave në shtatë komuna 56
Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale – Zgjedhjet për Kuvend 2010 56
Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale – Zgjedhjet për Kuvend 2014 57
Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale – Zgjedhjet për Kuvend 2017 57
Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale – Zgjedhjet për Kuvend 2019 57
Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale – Zgjedhjet Lokale 2009 58
Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale – Zgjedhjet Lokale 2013 58
Përqindja e pjesëmarrjes në votime sipas grupmoshave në zonat urbane dhe rurale – Zgjedhjet Lokale 2017 58
Përqindja e pjesëmarrjes në votime përmes postës e votuesve të regjistruar 60
Përqindja e votave me kusht sipas llojit 61
Përqindja e votave me kusht të konfirmuara dhe të refuzuara 62
Përqindja e votave me kusht sipas gjinisë 62
Përqindja e votuesve me kusht sipas grupmoshës – Zgjedhjet për Kuvend 2010 63
Përqindja e votuesve me kusht sipas grupmoshës – Zgjedhjet për Kuvend 2014 63
Përqindja e votuesve me kusht sipas grupmoshës – Zgjedhjet për Kuvend 2017 63
Përqindja e votuesve me kusht sipas grupmoshës – Zgjedhjet për Kuvend 2019 63
Përqindja e votuesve me kusht sipas grupmoshës – Zgjedhjet Lokale 2009 63
Përqindja e votuesve me kusht sipas grupmoshës – Zgjedhjet Lokale 2013 63
Përqindja e votuesve me kusht sipas grupmoshës – Zgjedhjet Lokale 2017 63
Pjesëmarrja në votime e Votuesve me Nevoja të Veçanta në Zgjedhje për Kuvend dhe Zgjedhje Lokale 64

HYRJE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) organizon dhe administron zgjedhjet në Republikën e Kosovës, për të siguruar proces zgjedhor transparent dhe të besueshëm. Çdo palë zgjedhje, KQZ fton qytetarët e Kosovës me të drejtë vote për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për të votuar. Kjo analizë ka për qëllim identifikimin e trendeve të pjesëmarrjes së votuesve në gjashtë palë zgjedhjet e fundit në nivel vendi. Konkretisht, analiza përfshinë trendet në Zgjedhjet Lokale 2009, 2013 dhe 2017 si dhe Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010, 2014, 2017 dhe 2019. Analiza e trendeve për Zgjedhje Lokale përfshinë vetëm trendet e pjesëmarrjes në votime për Kuvendin Komunal.

Kjo analizë gjithëpërfshirëse e trendeve përfshinë trendet sipas komunës, gjinisë, grupmoshave si dhe zonave urbane e rurale. Trendet janë të ndara në nivel të vendvotimeve të rregullta dhe në nivel të votave me kusht, ku përfshihen votat e votuesve nga vendvotimet e dyfishta dhe votat e votuesve që kanë përdorur shërbimin për votim me nevoja të veçanta. Te votat me kusht përfshihen edhe të dhënat për vota me kusht të konfirmuara dhe të refuzuara. Për me tepër, analiza përfshin trendet në regjistrim për shërbimin e votimit me nevoja të veçanta dhe shërbimin e votimit përmes postës, si dhe trendet e votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje përmes këtyre shërbimeve.

SHKURTESAT

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
LPV	Lista Përfundimtare e Votuesve
VPNV	Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta

PËRKUFIZIMET

Pjesëmarrja në votime
Përqindja e votuesve të regjistruar në Listën Përfundimtare të Votuesve dhe Listën e Votuesve me Postë të cilët kanë hedhur votën në vendvotim dhe jashtë vendvotimit (me kusht, me postë, dhe përmes votimit me nevoja të veçanta).

Vendvotim i rregullt
Lokacioni ku mund të hedhin votën vetëm votuesit e regjistruar në Listën Përfundimtare të Votuesve në atë vendvotim.

Vendvotim i dyfishtë
Lokacioni ku mund të votojnë votuesit e regjitruar në Listën Përfundimtare të Votuesve të atij vendvotimi si dhe votuesit që votojnë me kusht.

Votim i rregullt
Hedhja e votës në vendvotimin ku votuesi/ja gjendet në Listën Përfundimtare të Votuesve.

Votim me kusht
Shërbim që u mundëson votuesve të votojnë me kusht, në rast se ata nuk e gjejnë emrin në Listën Përfundimtare të Votuesve në qendrën e votimit ku shkojnë për të votuar.

Votimi përmes postës
Shërbim që u mundëson qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit të votojnë përmes postës nëse përmbushin kriteret e zotësisë juridike.

Votimi me nevoja të veçanta
Shërbim i KQZ-së që mundëson votimin e personave me aftësi të kufizuar, të hospitalizuar, në burgje, dhe kategorive tjera të cilët nuk mund të votojnë në vendvotim të rregullt. Këtyre personave u mundësohet votimi përmes ekipeve mobile.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Analiza e trendeve të pjesëmarrjes në zgjedhjet 2009-2019 është analizë sasiore e të dhënave statistikore që i posedon KQZ-ja. Qëllimi i kësaj analize është identifikimi i trendeve që mund të shfrytëzohen nga KQZ, hisedarët e vet, si dhe bota akademike për të përmirësuar procesin zgjedhor në Kosovë si dhe për të nxjerrë përfundime që mund t'i kontribojnë fushës së zgjedhjeve dhe demokratizimit të shoqërisë.

Trendet e regjistrimit të votuesve dhe pjesëmarrjes në gjashtë zgjedhjet e fundit në Kosovë tregojnë ngritje të vazhdueshme të numrit të votuesve të regjistruar (1,563,741 në Zgjedhjet Lokale 2009 ndërsa 1,890,952 në Zgjedhjet Lokale 2017) si dhe numrit të atyre që kanë marrë pjesë në votime (656,245 votues në Zgjedhjet Lokale 2009 ndërsa 811,717 votues në Zgjedhjet Lokale 2017). Për sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes në votime, te zgjedhjet Lokale përqindja e pjesëmarrjes ka mbetur e përafërt, me përjashtim të Zgjedhjeve Lokale 2013 (46.72%), ndërsa në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës kjo përqindje është zvogëluar (2010 - 45.35%, 2014 – 42.76%, dhe 2017 – 41.30%), ndërsa në zgjedhjet e vitit 2019 shënohet rritje e përqindjes së pjesëmarrjes në zgjedhje (44.39%).

Trendet në bazë të gjinisë përkojnë me trendet e përgjithshme në aspekt të rritjes së numrit të votuesve të regjistruar dhe atyre që kanë marrë pjesë në zgjedhje. Në përgjithësi vërehet se votuesit burra votojnë dukshëm më shumë se sa votueset gra. Konkretisht, në tre zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës kanë votuar më shumë se 109 mijë votues burra në krahasim me votueset gra. Ndërsa, dallimi në mes votuesve burra dhe gra për zgjedhje lokale ka qenë mbi 88 mijë, përveç Zgjedhjeve Lokale 2013 ku ka pasur pjesëmarrje më të lartë të grave (mbi 37 mijë). Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2019 kanë shënuar numrin më të madh të meshkujve që kanë votuar, mbi 462 mijë.

Analiza e pjesëmarrjes në votime sipas grupmoshës tregon se grupmoshat 18-21 vjeç dhe 41-64 vjeç kanë përqindje më të lartë të pjesëmarrjes në votime, të përcjellur nga grupmoshat 22-25 vjeç dhe 26-40 vjeç, e më pas nga ato 65-99 vjeç dhe >100 vjeç. Në grupmoshën >100 vjeç, vërehet një zbritje e vazhdueshme e pjesëmarrjes në votim e cila vjen si rezultat i rritjes së numrit të votuesve në LPV (nga 850 votues në Zgjedhjet Lokale 2009 në 2,906 votues në Zgjedhjet Lokale 2017) dhe zbritjes së votuesve që kanë votuar (nga 77 votues në Zgjedhjet Lokale 2009 në 40 votes në Zgjedhjet Lokale 2017). Edhe në Zgjedhjet e fundit për Kuvdend pjesëmarrja më e lartë është regjistruar te grupmoshat 18 -21 dhe 41 – 64 vjeç.

Trendet në bazë të zonave urbane dhe rurale të nxjerra nga të dhënat në shtatë Komunat me numrin më të madh të votuesve të regjistruar tregojnë se përqindja e pjesëmarrjes në votime në zona urbane është më e lartë në krahasim me ato rurale, përveç në Zgjedhjet Lokale 2009 ku përqindja e pjesëmarrjes në të dy zonat është e përafërt. Në Komunën e Gjakovës ka dallim më të theksuar në mes te pjesëmarrjes në votime të zonave urbane dhe rurale, ku pjesëmarrja në zona urbane është rreth 10% më e lartë se ajo në zona rurale. Përqindje të përafërta të daljes në votime vërehen në Pejë, Prishtinë dhe Prizren, ku në të tri Komunat ka dalje pak më të lartë në zona urbane se sa në ato rurale. Trende ndryshe vërehen në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe Ferizajt, ku ka pasur pjesëmarrje më të lartë në votime në zona rurale se sa në ato urbane.

Për dallim të votimit të rregullt, pjesëmarrja në votime, si total, përmes votimit jo të rregullt (votat me kusht, me postë, dhe VPNV) ka shënuar rënië tek zgjedhjet Lokale ndërsa ka mbetur i përafërt në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Votimi me kusht, përmes votimit në vendvotime të dyfishta mbetet kategoria më e shfrytëzuar e votimit jo të rregullt. Votimi në vendvotime të dyfishta është më i lartë në zgjedhje për Kuvendin e Kosovës, ku Kosova është një zonë zgjedhore, në krahasim me zgjedhjet Lokale, ku secila Komunë është zonë zgjedhore në vete. Në përgjithësi, përqindja e votave me kusht është zvogëluar në raport me numrin e përgjithshëm të votuesve në listën e votuesve. Analiza e votave me kusht tregon një trend të rritjes së përqindjes së votave të konfirmuara dhe zbritjes së numrit të votave të refuzuara ndër zgjedhje. Votimi përmes postës mbetet shërbim i rëndësishëm i KQZ-së, për të cilin regjistrohen 10,000 - 15,000 votues që jetojnë jashtë Kosovës, e që përbëjnë më pak se 1.5% e totalit të votuesve që dalin në zgjedhje.

METODOLOGJIA

Analiza e trendeve bazohet në metoda sasiore. Të dhënat e përfshira në analizë janë mbledhur nga baza e të dhënave të rezultateve përfundimtare nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), nga ku janë certifikuar rezultatet e secilës palë zgjedhje. Konkretisht, të dhënat janë marrë nga Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV), ku bëhet regjistrimi i të gjithë votuesve që kanë votuar si të rregullt. Përveç kësaj, bëhet edhe regjistrimi i të gjithë votuesve që kanë votuar me kusht dhe nevoja të veçanta, si dhe regjistrimi i të gjithë votuesve që kanë votuar me postë, i cili bëhet përmes Shërbimit Votues të KQZ-së. Të gjitha këto të dhëna ndërtojnë bazën e analizës së trendeve.

Analiza pasqyron trendet e pjesëmarrjes së votuesve në:

1. *Votim të rregullt, dhe*
2. *Votim me kusht, duke përfshirë votuesit me nevoja të veçanta.*

Brenda këtyre dy llojeve janë bërë analiza në bazë të llojit të zgjedhjeve, duke bërë krahasime brenda llojit të zgjedhjeve. Gjatë krahasimit të trendeve brenda llojit të zgjedhjeve është bërë analiza në bazë të këtyre kategorive të trendeve:

1. *Trendet e përgjithshme;*
2. *Trendet sipas komunave;*
3. *Trendet sipas gjinisë;*
4. *Trendet sipas grupmoshave.*

Grupmoshat janë të ndara si në vijim: 1) 18-21 vjeç, që përfshinë votuesit që votojnë për herë të parë, 2) 22-25 vjeç si votues që kanë pasur rast të votojnë së paku dy herë, 3) 26-40 vjeç si dhe 4) 41-64 vjeç, votuesit e moshës ekonomikisht aktive, 5) 65-99 vjeç, votuesit e dalur në pension, dhe 6)>100 vjeç, që përfshinë personat e vjetër dhe që në këtë analizë ndihmon në vlerësimin e kualitetit të listës votuese.

Analiza e trendeve të votuesve që kanë votuar të rregullt përfshinë edhe trendet në bazë të zonave urbane dhe rurale. Kjo pasqyron të dhënat e shtatë Komunave më të mëdha të Kosovës, që përbëjnë rreth 45% të vendvotimeve dhe votuesve të regjistruar në LPV. Këto Komuna përfshijnë Gjakovën, Gjilanin, Mitrovicën e Jugut*, Pejën, Prishtinën, Prizrenin dhe Ferizajin. Zonë urbane brenda këtyre Komunave konsiderohet qyteti, ndërsa zonat rurale përfshijnë fshatrat. Analiza e trendeve në zona urbane dhe rurale është bërë edhe në bazë të trendeve sipas gjinisë dhe grupmoshës.

Zgjedhjet në Komunën e Parteshit janë organizaur për herë të parë në vitin 2010 ndërsa në Komunën e Mitrovicës së veriut në vitin 2013. Për këtë arsye nuk ka të dhëna për këto dy Komuna në Zgjedhjet Lokale 2009, dhe për Mitrovicën e veriut edhe për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010.

Përveq analizës për pjesëmarrje në votime, është bërë edhe analiza e trendeve të personave të regjistruar për shërbimin e votimit me nevoja të veçanta dhe atë të votimit përmes postës, në raport me personat që e kanë shfrytëzuar këto shërbime.

Duke qenë analizë sasiore, ky raport pasqyron vetëm trendet e pjesëmarrjes në votime në gjashtë palë zgjedhjet e fundit në nivel vendi, por jo edhe arsyet pas këtyre trendeve. Për të kuptuar pse ka dalje më të madhe apo më të vogël brenda kategorive të ndryshme duhet një analizë më e thellë cilësore.

Sqarime shtesë:

1. Në këtë raport, të dhënat për Mitrovicën në Zgjedhjet Lokale 2009 dhe ato për Kuvendin e Kosovës 2010 përfshijnë të dhënat për Mitrovicën e Jugut dhe Veriut bashkë. Pas procesit të decentralizimit janë krijuar dy Komuna - Mitrovica e Jugut dhe e Veriut, dhe nga Zgjedhjet Lokale 2013 të dhënat janë pasqyruar ndaras për këto dy Komuna. Me qëllim të thjeshtëzimit, në këtë analizë përdoret termi Mitrovicë e Jugut edhe për Mitrovicën gjatë Zgjedhjeve Lokale 2009 dhe atyre për Kuvendin e Kosovës 2010.

2. Të dhënat për Zgjedhjet Lokale i referohen vetëm Zgjedhjeve për Kuvende Komunale, pra jo edhe atyre për Kryetarë të Komunave.



PJESA E PARË

1. TRENDET E PËRGJITHSHME ZGJEDHORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, 2009 – 2019

Të dhënat tregojnë se ka pasur rritje të vazhdueshme të votuesve të regjistruar si dhe të pjesëmarrjes në votime në shtatë palë zgjedhjet e fundit në nivel të vendit. Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të vitit 2019 kanë shënuar numrin më të madh të votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje. Deri para zgjedhjeve të vitit 2019, vërehet një trend i pjesëmarrjes më të lartë në Zgjedhje Lokale[1] në raport me ato për Kuvendin e Kosovës, sidomos në dy palë zgjedhjet e fundit (2013 dhe 2017).

ZGJEDHJET	NUMRI I VOTUESVE TË REGJISTRUAR NË LPV	NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR SI TË RREGULLT
2009 – ZGJEDHJET LOKALE	1,563,741	656,245
2010 – ZGJEDHJET PËR KUVEND	1,630,636	707,656
2013 – ZGJEDHJET LOKALE	1,779,357	812,813
2014 – ZGJEDHJET PËR KUVEND	1,782,454	734,516
2017 – ZGJEDHJET PËR KUVEND	1,872,941	747,161
2017 – ZGJEDHJET LOKALE	1,890,952	811,717
2019 – ZGJEDHJET PËR KUVEND	1,937,868	826,997

Tabela 1: Trendet e përgjithshme të votuesve të regjistruar dhe votuesve që kanë votuar në ditën e zgjedhjeve.

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme pasqyrojnë votuesit e regjistruar në Listën Përfundimtare të Votuesve për secilën palë zgjedhje dhe vetëm numrin e votuesve të cilët kanë votuar në vendvotimin e rregullt në Ditën e Zgjedhjeve. Këtu nuk përfshihen të dhënat për numrin e votuesve dhe pjesëmarrjen e tyre për votuesit jashtë vendit; votuesit me kusht dhe votuesit me nevoja të veçanta.



[1] *Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës organizohen për zgjedhjen e (38) Kryetarëve të Komunave dhe (38) Kuvendeve Komunale. Të dhënat për Zgjedhjet Lokale i referohen vetëm Zgjedhjeve për Kuvende Komunale, pra jo edhe atyre për Kryetarë të Komunave.*

1.1. Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës: 2010; 2014; 2017 dhe 2019

Tabelat në vijim tregojnë të dhënat për të gjitha llojet e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, në raport me numrin e votuesve të regjistruar:

2010 ZGJEDHJET PËR KUVEND	NUMRI I VOTUESVE TË REGJISTRUAR	NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR	% E PJESËMARRJES NË VOTIM
Votimi i rregullt	1,630,636	707,656	43.40%
Votimi me kusht në vendvotime të dyfishta		28,487	1.75%
Votimi me nevoja të veçanta		3,002	0.18%
Votimi me postë	1,640	1,053	64.21%
Totali	**1,632,276**	**740,198**	**45.35%**

Tabela 2: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010.

2014 ZGJEDHJET PËR KUVEND	NUMRI I VOTUESVE TË REGJISTRUAR	NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR	% E PJESËMARRJES NË VOTIM
Votimi i rregullt	1,782,454	734,516	41.21%
Votimi me kusht në vendvotime të dyfishta		22,073	1.24%
Votimi me nevoja të veçanta		2,071	0.12%
Votimi me postë	16,569	10,648	64.26%
Totali	**1,799,023**	**769,308**	**42.76%**

Tabela 3: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2014.

2017 ZGJEDHJET PËR KUVEND	NUMRI I VOTUESVE TË REGJISTRUAR	NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR	% E PJESËMARRJES NË VOTIM
Votimi i rregullt	1,872,941	747,161	39.89%
Votimi me kusht në vendvotime të dyfishta		25,378	1.35%
Votimi me nevoja të veçanta		1,911	0.10%
Votimi me postë	15,118	5,246	34.7%
Totali	**1,888,059**	**779,696**	**41.3%**

Tabela 4: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017.

2019 ZGJEDHJET PËR KUVEND	NUMRI I VOTUESVE TË REGJISTRUAR	NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR	% E PJESËMARRJES NË VOTIM
Votimi i rregullt	1,937,868	826,997	42.68%
Votimi me kusht në vendvotime të dyfishta		26,382	1.36%
Votimi me nevoja të veçanta		2,142	0.11%
Votimi me postë	35,087	20,200	57.57%
Totali	**1,972,955**	**875,721**	**44.39%**

Tabela 5: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019.

Të dhënat shfaqin trendet në vijim:

1. Ka pasur rënie të numrit të votuesve me kusht nga 28,487 në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010 në 22,073 në 2014 (29% më pak), ndërsa një ngritje në 25,378 vota me kusht në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2017 në raport me zgjedhjet paraprake (13.1% më shumë). Për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës i gjithë territori i Republikës së Kosovës

konsiderohet si një zonë e vetme zgjedhore, ku votuesit mund të votojnë më kusht kudo brenda vendit, pra jo vetëm brenda territorit të Komunës së tyre si në zgjedhjet Lokale.

2. Ka pasur zbritje të vazhdueshme të pjesëmarrjes në votime të votuesve me nevoja dhe rrethana të veçanta. Kjo mund t'i atribuohet edhe afateve të shkurtuara për aplikim për këtë shërbim, pasi që zgjedhjet kanë qenë të parakohshme me periudha minimale për organizim.

3. Trendet në numrin e votuesve të regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Vendit nuk kanë dallim prej trendeve në zgjedhjet Lokale. Në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2014 ka pasur një rritje prej më se 10 herë më shumë se sa në zgjedhjet 2010, ndërsa ka pasur një rënie prej 8.8% në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2017 në raport në zgjedhjet qendrore paraprake.

4. Pjesëmarrja në votime përmes postës ka shënuar rritje për më shumë se 5 herë nga Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010 në ato 2014, ndërsa në zgjedhjet pasuese për Kuvendin e Kosovës numri i votuesve që kanë votuar përmes postës është përgjysmuar, por është shënuar sërish rritje në zgjedhjet e vitit 2019, duke regjistruar njëkohësiht numrin më të madh të tyre.

1.2. Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet Lokale: 2009; 2013 dhe 2017

Tabelat në vijim tregojnë të dhënat për të gjitha llojet e pjesëmarrjes në votime në Zgjedhjet Lokale, në raport me numrin e votuesve të regjistruar:

2009 ZGJEDHJET LOKALE	**NUMRI I VOTUESVE TË REGJISTRUAR**	**NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR**	**% E PJESËMARRJES NË VOTIM**
Votimi i rregullt	**1,563,741**	656,245	41.97%
Votimi me kusht në vendvotime të dyfishta		25,420	1.63%
Votimi me nevoja të veçanta		1,539	0.10%
Votimi me postë	1,806	1,306	72.31%
Totali	**1,565,547**	**684,510**	**43.72%**

Tabela 6: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet Lokale 2009.

2013 ZGJEDHJET LOKALE	**NUMRI I VOTUESVE TË REGJISTRUAR**	**NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR**	**% E PJESËMARRJES NË VOTIM**
Votimi i rregullt	1,779,357	812,813	45.68%
Votimi me kusht në vendvotime të dyfishta		17,395	0.98%
Votimi me nevoja të veçanta		1,824	0.10%
Votimi me postë	13,556	5,677	41.88%
Totali	**1,792,913**	**837,709**	**46.72%**

Tabela 7: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet Lokale 2013.

2017 ZGJEDHJET LOKALE	**NUMRI I VOTUESVE TË REGJISTRUAR**	**NUMRI I VOTUESVE QË KANË VOTUAR**	**% E PJESËMARRJES NË VOTIM**
Votimi i rregullt	1,890,952	811,717	42.93%
Votimi me kusht në vendvotime të dyfishta		13,501	0.71%
Votimi me nevoja të veçanta		2,002	0.11%
Votimi me postë	10,476	6,735	64.29%
Totali	**1,901,428**	**833,955**	**43.86%**

Tabela 8: Statistikat e përgjithshme në Zgjedhjet Lokale 2017.

Të dhënat e paraqitura në tabelat e mësimpërme për Zgjedhjet Lokale (2009; 2013; 2017) shfaqin trendet në vijim:

1. Ka pasur rënie të numrit të votuesve me kusht nga 25,420 në Zgjedhjet Lokale 2009 në 13,501 në Zgjedhjet Lokale 2017. Kjo rënie mund t'i atribohet edhe procesit të vazhdueshëm të KQZ-së për alokim të votuesve sa më afër vendbanimeve të tyre.

2. Ka pasur një rritje të votuesve me nevoja dhe rrethana të veçanta që kanë marrë pjesë në votime. Në Zgjedhjet Lokale 2013 ka pasur 15.6% (286 votues me shume) rritje në raport me Zgjedhjet Lokale 2009, ndërsa 8.9% (177 votues më shumë) rritje nga Zgjedhjet Lokale 2013 në 2017.

3. Numri i votuesve të regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Vendit ka qenë më se shtatë herë më shumë në Zgjedhjet Lokale 2013 në raport me Zgjedhjet Lokale 2009. Pastaj ka pasur një rënie në Zgjedhjet Lokale 2017, ku ka pasur 3,080 aplikacione më pak se sa në zgjedhjet lokale paraprake.

4. Pjesëmarrja në votime përmes postës ka shënuar rritje të vazhdueshme nga Zgjedhjet Lokale 2009 në ato 2017. Në Zgjedhjet Lokale 2013 ka pasur rritje më se katër herë më shumë se sa në Zgjedhjet Lokale 2009, ndërsa në Zgjedhjet Lokale 2017 ka pasur rritje prej 17% në raport me zgjedhjet paraprake Lokale.

1.3. Përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje në Republikën e Kosovës, 2009 – 2019

Është e kuptueshme që përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje është e ndryshme nga njëri në tjetrin proces zgjedhor, megjithkëtë të dhënat tregojnë se kjo nuk ndryshon shumë. Kjo përqindje varion nga 41% deri në rreth 47%. Gjitahshtu, nëse analizohen të dhënat nga grafikoni, përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje është e ndryshme edhe brenda llojit të njëjtë të zgjedhjeve.



Në grafikon, përqindja është rezultat i përfshirjes së të gjithë votuesve të rregullt; votuesve me nevoja të veçanta, votuesve me kusht; dhe votuesve nga jashtë vendit (me postë).

Ndonëse ishte krijuar përshtypja që pas Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës (2010) përqindja e pjesëmarrjes kishte filluar të shënonte rënie në dy proceset zgjedhore pasuese (2014 dhe 2017), kjo ndryshoi pas Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës (2019) ku pjesëmarrja arriti në 44.39%.

Ndërkaq, trendi i përqindjes së pjesëmarrjes në Zgjedhje Lokale është pothuajse i njëjtë në dy procese zgjedhore (2009 dhe 2017), por pjesëmarrja më e lartë e shënuar deri më tani është regjistruar në procesin zgjedhor të vitit 2013 (46.72%).

Është e kuptueshme që përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje është e ndryshme nga njëri në tjetrin proces zgjedhor, megjithkëtë të dhënat tregojnë se kjo nuk ndryshon shumë. Kjo përqindje varion nga 41% deri në rreth 47%.

1.4. Trendet e pjesëmarrjes në Zgjedhje për Kuvend të Kosovës sipas komunave

Të dhënat në vijim tregojnë trendet te votuesit e rregullt sipas Komunave në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.



1.4.1. Pesë komunat me pjesëmarrjen më të lartë dhe më të ulët në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës

Tabelat në vijim tregojnë 5 Komunat me përqindje më të lartë në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës, si dhe 5 Komunat me përqindje më të ulët.

Të dhënat tregojnë se Komuna e Gllogocit, Prishtinës dhe Skenderajt kanë qenë Komunat me pjesëmarrje më të lartë në zgjedhjet 2010 dhe 2014, ndërsa në vitin 2017 nuk kanë arritur të jenë pjesë e 5 Komunave me përqindje më të lartë. Përveç kësaj, vërehet një ngritje e dukshme e pjesëmarrjës në votime në Komunën e Ranillukut dhe Zubin Potokut, të cilat kanë qenë ndër 5 Komunat me pjesëmarrje më të ulët në zgjedhjet 2010, ndërsa në zgjedhjet 2017 janë ndër 5 Komunat me pjesëmmarje më të lartë.

Në përgjithësi në trendet sipas Komunave vërehet një pjesëmarrje më e lartë në votime në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës. Përqindja më e lartë e pjesëmarrjës në votime në zgjedhjet 2010 ka qenë 59.61% në Mamushë, ndërsa në vitin 2017 dhe 2019 prin Zubin Potoku me 61.13% dhe me 55.18%.

	2010	2014	2017	2019
1	Mamushe (59.61%)	Gllogoc (49.72%)	Zubin Potok (61.13%)	Zubin Potok (55.18%)
2	Skenderaj (58.40%)	Kllokot (49.12%)	Shtërpcë (53.60%)	Shtërpcë (54.44%)
3	Gllogoc (54.29%)	Skenderaj (48.99%)	Partesh (51.31%)	Prishtinë (53.03%)
4	Prishtinë (51.71%)	Prishtinë (48.94%)	Novobërdë (50.70%)	Zveçan (50.60%)
5	Lipjan (51.68%)	Partesh (48.76%)	Ranilluk (49.99%)	Kllokot (50.38%)

Tabela 9: Pesë komunat me pjesëmarrjen më të lartë në votime në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

	2010	2014	2017	2019
1	Leposaviq (0.42%)	Mitrovicë e Veriut (17.00%)	Dragash (29.30%)	Dragash (31.98%)
2	Zveçan (1.12%)	Zveçan (22.18%)	Mitrovicë e Veriut (30.90%)	Klinë (34.99%)
3	Zubin Potok (6.24%)	Leposaviq (25.62%)	Klinë (32.40%)	Gjakovë (36.11%)
4	Mitrovicë (25.77%)	Dragash (33.29%)	Gjakovë (33.96%)	Junik (36.20%)
5	Ranilluk (30.70%)	Gjakovë (34.53%)	Istog (34.46%)	Rahovec (37.08%)

Tabela 10: Pesë komunat me pjesëmarrjen më të ulët në votime në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

Në dy proceset zgjedhore (2017 dhe 2019) vërehet edhe një dalje e ulët në Dragash dhe në disa komuna tjera si në Gjakovë dhe Klinë.

1.5. Trendet e pjesëmarrjes në Zgjedhje Lokale sipas komunave

Të dhënat në vijim tregojnë trendet te votuesit e rregullt sipas Komunave në Zgjedhjet për Lokale.



1.5.1. Pesë komunat me pjesëmarrjen më të lartë dhe më të ulët në Zgjedhjet Lokale

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikonin e mësipërm, ndryshimet më të mëdha në pjesëmarrje në votime vërehen në Komunat e Gllogocit, Gracanicës, Kllokotit, Leposavicit, Novobërdës, Ranillukut, Shtërpcës, Skenderajt, Zubin Potokut, dhe Zveçanit.

Tabelat në vijim tregojnë 5 Komunat me përqindje më të lartë në zgjedhjet e fundit Lokale në nivel të vendit, si dhe 5 Komunat me përqindje më të ulët. Trendet sipas Komunave tregojnë se Mamusha dhe Hani i Elezit kanë pasur përqindjën më të lartë të pjesëmarrjes në votime në tre zgjedhjet e fundit Lokale.

Një gjetje tjetër e dukshme është Komuna e Skenderajt e cila ka qenë komuna e tretë për nga përqindja e lartë në vitin 2009, ndërsa në zgjedhjet 2013 gjendet në grupin e pesë Komunave me përqindje më të ulët, dhe në zgjedhjet 2017 është ndër Komuna me pjesëmarrje më të ulët.

	2009	2013	2017
1	Gllogoc (62.40%)	Mamushë (63.48%)	Mamushë (63.99%)
2	Mamushë (62.05%)	Partesh (63.13%)	Kllokot (62.37%)
3	Skënderaj (58.79%)	Kllokot (62.78%)	Partesh (55.86%)
4	Hani i Elezit (54.76%)	Hani i Elezit (61.72%)	Hani i Elezit (55.78%)
5	Shtime (50.38%)	Shtërpcë (58.30%)	Shtërpcë (55.29%)

Tabela 11: Pesë komunat me pjesëmarrjen më të lartë në votime në Zgjedhjet Lokale.

	2009	2013	2017
1	Zveçan (0.33%)	Zveçan (16.95%)	Skenderaj (30.72%)
2	Leposaviq (0.40%)	Mitrovicë e Veriut (21.75%)	Dragash (35.83%)
3	Zubin Potok (6.64%)	Leposaviq (22.77%)	Mitrovicë e Veriut (36.71%)
4	Ranilluk (11.78%)	Zubin Potok (28.07%)	Gjakovë (37.27%)
5	Graçanicë (21.63%)	Skenderaj (38.35%)	Klinë (38.28%)

Tabela 12: Pesë komunat me pjesëmarrjen më të ulët në votime në Zgjedhjet Lokale.

Në përgjithësi në trendet sipas Komunave vërehet një pjesëmarrje më e madhe në votime ndër zgjedhjet e fundit Lokale. Përqindja më e lartë e pjesëmarrjës në votime në zgjedhjet 2009 ka qenë 62.40% në Gllogoc, ndërsa në vitin 2017 dalja më e lartë ka qenë në Mamushë me 63.99%.

PJESA E DYTË

2. PJESËMARRJA NË ZGJEDHJE SIPAS GJINISË: KUSH VOTON MË SHUMË?

- Kush merr pjesë më shumë në votime: meshkujt apo femrat?

- A ka më shumë votues meshkuj apo femra?

Këto janë vetëm disa nga pyetjet që bëhen shpesh sa herë që diskutohet për pjesëmarrjen në votime në Republikën e Kosovës. Tabela në vazhdim tregon pikërisht trendet e pjesëmarrjes në zgjedhje sipas gjinisë. Të dhënat e pasqyruara në këtë tabelë përfshijnë vetëm votuesit që kanë hedhur votën në vendvotimet e rregullta në raport me votuesit e regjistruar në Listën Përfundimtare të Votuesve. Në këtë tabelë nuk janë përfshirë të dhënat për votuesit me kusht; votuesit me nevoja të veçanta dhe votuesit nga jashtë vendit (me postë).

	VOTUES MESHKUJ TË REGJISTRUAR	NUMRI I VOTUESVE MESHKUJ QË VOTUAN	VOTUESE FEMRA TË REGJISTRUAR	NUMRI I VOTUESVE FEMRA QË VOTUAN
2009 – Zgjedhjet Lokale	807,011	**372,551**	756,730	**283,694**
2010 – Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës	840,946	**411,376**	789,690	**296,280**
2013 – Zgjedhjet Lokale	912,321	**387,627**	867,036	**425,186**
2014 – Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës	912,797	**421,824**	869,657	**312,692**
2017 – Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës	956,580	**431,212**	916,361	**315,949**
2017 – Zgjedhjet Lokale	966,147	**453,812**	924,805	**357,905**
2019 – Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës	987,673	**462,009**	950,195	**364,988**

Tabela 13: Numri i votuesve të regjistruar dhe atyre që votuan të ndarë sipas gjinisë.

Duke u mbështetur në të dhënat nga Listat Përfundimtare të Votuesve (2009, 2010; 2014; 2017; 2019), në secilin nga proceset zgjedhore të organizuara gjatë kësaj periudhe, meshkujt përbëjnë numrin më të madh të votuesve në vendin tonë. Gjithashtu, edhe pjesëmarrja në votime është më e lartë tek meshkujt. Kjo nuk vlen vetëm për Zgjedhjet Lokale të vitit 2013 kur është regjistruar pjesëmarrja më e lartë e femrave në historinë e zgjedhjeve në Kosovë. Kjo pjesëmarrje, në po të njëjtin proces zgjedhor, ishte dukshëm më e lartë edhe në raport me meshkujt për 37,559 votuese. Numri i meshkujve që kanë votuar më së shumti në një proces zgjedhor gjatë kësaj periudhe është regjistruar në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës (2019).











Pjesëmarrja në Zgjedhje për Kuvend të Kosovës sipas gjinisë







Pjesëmarrja në Zgjedhjet Lokale sipas gjinisë

2.1. Pjesëmarrja sipas gjinisë në Zgjedhje për Kuvend në të gjitha komunat e Kosovës

Të dhënat në vazhdim pasqyrojnë pjesëmarrjen në Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës, me theks të veçantë për pjesëmarrjen e meshkujve në katër proceset zgjedhore parlamentare (2010; 2014; 2017 dhe 2019).



Ndërsa, tabela në vazhdim pasqyron përqindjen e pjesëmarrjes së femrave në Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës (2010; 2014 dhe 2019).



2.1.1. Të gjeturat për pjesëmarrjen në Zgjedhje për Kuvend sipas gjinisë dhe komunave të Kosovës

Trendet tregojnë dallim të theksuar në pjesëmarrjen e meshkujve dhe femrave në zgjedhje për Kuvendin e Kosovës. Përderisa kemi numër të madh të Komunave me pjesëmarrje mbi 50% të meshkujve (15 Komuna në zgjedhjet 2010, 11 Komuna në zgjedhjet 2014, 9 në ato 2017 dhe 15 në 2019), numri i Komunave me pjesëmarrje mbi 50% të femrave është shumë i vogël (1 Komunë në zgjedhjet 2010, asnjë në zgjedhjet 2014 dhe 2 në ato 2017 dhe dy në 2019).

Komunat me pjesëmarrje më të lartë të femrave dhe meshkujve në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010 kanë qenë Mamushë (65.50% meshkuj dhe 52.86%) dhe Skenderaj (67.50% meshkuj dhe 48.21% femra). Në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2014 pjesëmarrja e meshkujve ka qenë më e lartë në Komunat e Gllogocit (58.28%), Skenderajt (56.41%) dhe Lipjanit (53.81%) ndërsa pjesëmarrja e femrave ka qenë më e lartë në komunat e Parteshit (45.53%), Shtërpcës (45.03%) dhe Kllokotit (44.79%). Në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2017 pjesëmarrja më e lartë e dy gjinive ka qenë në Zubin Potok (61.10% meshkuj dhe 61.17% femra) dhe Shtërpcë (55.70% meshkuj dhe 51.40% femra). Ndërsa, në zgjedhjet e fundit 2019 përqindja më e lartë e pjesëmarrjes së meshkujve në zgjedhje është regjistruar në komunën e Mamushës (53.89%), ndërsa ajo e femrave është shënuar në Ranilluk (47.60%).

Disa ndër Komunat me ndryshime me të theksueshme në votues meshkuj ndër zgjedhje për Kuvendin e Kosovës janë si në vijim:

KOMUNAT	2010	2014	2017	2019
SKËNDERAJ	67.50%	56.41%	46.00%	45.06%
RANILLUK	33.14%	47.47%	53.66%	52.21%
MAMUSHË	65.50%	52.75%	47.66%	53.89%
GLLOGOC	63.75%	58.28%	49.01%	50.99%
HANI I ELEZIT	55.83%	49.43%	43.86%	47.31%

Tabela 14: Komunat me ndryshimet më të mëdha te votuesit meshkuj në Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës.

Në të njejtat komuna ka pasur edhe ndryshime të theksueshme në votuese femra ndër zgjedhje për Kuvendin e Kosovës. Përqindja e pjesëmarrjës së femrave në votime ka qenë si në vijim:

KOMUNAT	2010	2014	2017	2019
SKENDERAJ	48.21%	40.79%	27.44%	29.77%
RANILLUK	28.05%	39.79%	46.11%	47.60%
MAMUSHË	52.86%	43.31%	36.58%	38.01%
HANI I ELEZIT	41.02%	36.12%	27.43%	35.02%
GLLOGOC	43.95%	40.57%	29.46%	32.69%

Tabela 15: Komunat me ndryshimet më të mëdha te votuesit femra në Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës.

2.2. Pjesëmarrja sipas gjinisë në Zgjedhjet Lokale në të gjitha komunat e Kosovës

Të dhënat në vazhdim tregojnë se pjesëmarrja më e lartë e meshkujve është shënuar në disa komuna dhe atë në vitin 2009. Siaps tabelës së mëposhtme gjatë zgjedhjeve të vitit 2009 kjo përqindje e pjesëmarrjes ka shkuar në mbi 60% në disa raste. Ndërkaq, edhe në zgjedhjet e vitit 2017 është regjistruar në disa raste përqindje e konsiderueshme e pjesëmarrjes në zgjedhje, në shumë raste mbi 50%.

Përqindja e pjesëmarrjes së meshkujve në Zgjedhjet Lokale sipas komunave



	2017	2013	2009
Deçan	42.00%	37.76%	45.02%
Gjakovë	40.52%	38.39%	48.63%
Gllogovc	52.97%	47.63%	67.91%
Gjilan	49.22%	46.61%	47.24%
Dragash	38.12%	35.31%	37.52%
Istog	42.23%	39.76%	45.64%
Kaçanik	52.23%	44.15%	54.14%
Klinë	42.49%	41.04%	49.87%
Fushë Kosovë	47.49%	43.83%	50.75%
Kamenicë	50.32%	46.32%	47.88%
Mitrovicë	43.92%	39.00%	37.18%
Leposaviq	47.01%	22.15%	0.65%
Lipjan	53.53%	49.81%	55.62%
Novobërdë	56.78%	50.48%	25.00%
Obiliq	54.96%	48.81%	48.67%
Rahovec	45.43%	43.32%	44.57%
Pejë	41.68%	37.29%	41.17%
Podujevë	53.20%	46.86%	51.34%
Prishtinë	50.79%	46.58%	45.02%
Prizren	43.06%	39.99%	43.07%
Skenderaj	38.90%	38.99%	63.45%
Shtime	54.26%	48.04%	55.75%
Shtërpcë	56.72%	49.24%	30.80%
Suharekë	46.50%	44.63%	49.39%
Ferizaj	51.17%	44.97%	48.28%
Viti/Vitina	46.09%	41.45%	46.53%
Vushtrri	49.16%	44.07%	47.72%
Zubin Potok	47.03%	25.00%	6.71%
Zveçan	49.35%	15.65%	0.62%
Malishevë	47.77%	48.20%	50.83%
Junik	44.35%	37.21%	43.65%
Mamushe	63.75%	59.04%	65.32%
Hani i Elezit	58.03%	54.63%	58.09%
Gracanica	42.16%	44.98%	23.62%
Ranilluk	57.30%	48.41%	12.90%
Partesh	56.41%	54.75%	N/A%
Kllokot	64.72%	55.16%	26.22%
Mitrovicë e Veriut	37.58%	19.91%	N/A%

Për dallim nga përqindja e lartë e meshkujve (mbi 60% në shumë raste) e regjistruar në zgjedhjet e vitit 2009, kur flasim për përqindjen e pjesëmarrjes së femrave në zgjedhje sipas komunave, kjo dallon. Në fakt, kjo përqindje e pjesëmarrjes së femrave në zgjedhje është shpeshherë mbi 50% apo 60%. Por, ka edhe raste kur kjo përqindje e pjesëmarrjes kalon mbi 70%.



2.2.1. Të gjeturat për pjesëmarrjen në Zgjedhje Lokale sipas gjinisë dhe komunave të Kosovës

Trendet tregojnë ndryshime radikale në pjesëmarrje të femrave në zgjedhje Lokale, ku në Zgjedhjet Lokale 2009 ka pasur 4 komuna me pjesëmarrje të femrave mbi 50%, ndërsa në Zgjedhjet Lokale 2013 ka pasur 20 komuna me mbi 50% dalje të femrave. Ky numër është zvogëluar në Zgjedhjet Lokale 2017, ku 7 komuna kanë pasur dalje mbi 50% të femrave. Në anën tjetër, numri i Komunave me pjesëmarrje mbi 50% të meshkujve ka qenë 10 në Zgjedhjet Lokale 2009, 5 në 2013, ndërsa 16 në 2017.

